



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë -Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 323 /2025

Datë: 07 / 07 /2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7, 01 mars 2019), duke u bazuar ne nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Zëvendësministri në detyrë i Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ministria e Drejtësisë shpallet jo kompetente për të vepruar sipas Ankesës nr.08-711, të datës 08.04.2025, e parashtruar nga z. Rasim Ramaj kundër Vendimit nr. 08/2025, të datës 01.04.2025 të Këshillit Drejtues të Odës së Noterëve të Kosovës.

2.Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me datën 08.04.2025 Rasim Ramaj ka parashtruar në Ministrinë e Drejtësisë ankesë kundër Vendimit nr. 08/2025, të datës 01.04.2025 të Këshillit Drejtues të Odës së Noterëve të Kosovës, për shkak vërtetimit të gabuar të dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Pas pranimit të ankesës, Ministria e Drejtësisë duke u bazuar në dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi, ka vlerësuar se ankesa e parashtruar nga z. Rasim Ramaj, nuk bie brenda kompetencës së saj për shqyrtim dhe vendosje. Si rrjedhojë, Ministria e Drejtësisë shpallet jo kompetente për të vepruar në këtë rast.

Andaj, në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Blerim SALLAHU

Zëvendësministër në detyrë i Drejtësisë

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Vendimi i'u dërgohet:

- *Z. Rasim Ramaj, parashtrues i ankesës;*
- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Sekretares së Përgjithshme;*
- *Odës së Noterëve të Kosovës;*
- *Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*